



DPK/DMP

03-183/2013

01

28.01.2013



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U  
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 14818/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtës kundër të pandehurës Krenare Sogojeva- Dermaku nga Prishtina, për kundërvajtje nga 8 paragrafi 1 e sanksionuar sipas dispozitës ndëshkimore neni 17 par 1 pika 1.1 te Ligjit nr. 04/L-050 te Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave për te gjithë personat zyrtar e në bazë të nenit 73,74,195, 199, të LMK me dt. 31.12.2012 merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**E PANDEHURA** : Krenare Fehmi Sogojeva- Dermaku, e lindur më 12.07.1981 ne Prishtinë, ku dhe tani jeton në rrugën e Llapit nr. 14, me profesion drejtoresh e departamentit ligjor në MFSK, e gjendjes së mesme ekonomike.

**Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s**

E pandehura në cilësinë drejtoreshës ne Departamentin Ligjor në Ministrinë e Forcës se Sigurisë, nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë, i cili bëhet me deklarimin e rregullt vjetor deri me datën 31.03.2012 të çdo viti kalendarik në Agjensionit Kundër Korrupsionit

Me këtë ka kryer vepër kundërvajtës nga neni 8 paragrafi 1 e sanksionuar sipas dispozitës ndëshkimore neni 17 par 1 pika 1.1 te Ligjit nr. 04/L-050 te Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave për te gjithë personat zyrtar, andaj për këtë:

**Q O R T I M**

Shpenzime të procedurës nuk ka patur,

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

**A r s y e t i m**

Agjensia Kundër Korrupsionit, parashtrori kërkesën nr.011597/2012 të dt 02.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtës kundër të pandehurit së përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur, ku dhe është marrë konkluzioni për fillimin e procedurës kundërvajtës.

Gjatë procedurës u dëgjua e pandehura e cila në deklaratën e saj, deklaroi se që nga vitit 2008 jam emëruar në pozitën e drejtoreshës ne departamentin Ligjor ne kuadër te Ministrisë se Forcës se Sigurisë dhe sa i përket deklarimit te pasurisë unë çdo herë kam deklaruar dhe e kam mbushur formularin për deklarimin e pasurisë porsa i përket vit te tanishëm qe nuk e kam mbush këtë formular ne afatin ligjor te paraparë është se në 6 muajt e fundit unë kam qenë në pushim te lehonisë, dhe pas lehonisë kam pas probleme te cilat me kanë përcjell një kohë të gjatë ku nuk kam qenë më shëndet mirë dhe mund te them se 3 muaj pas lindjes nuk kam mund te dal nga shtëpia, pasi qe përveç problemeve te mija me shëndet po ashtu kam pas probleme me vajzë, ku vajza ka pas problem me qafen sepse e kam mbajtur kokën në aknen e majtë ku është konstatuar se ka pas muskujt e shkurt te qafës në anën e majtë, ku është konstatuar se3 ka pas muskujt e shkurtet te qafës në anenë e majtë ku përkujdesja ime ka qenë shumë intensive si për shëndetin tim ashtu edhe te vajzës, ku mund te japë bashkangjese edhe provat te cilat dëshmojnë me se miri gjendjen time shëndetësore,

Andaj gjyqtari pas administrimit te provave dhe te provuarit te kësaj çeshtje me te drejtë dhe ne mënyre te plotë vërtetoi gjendjen faktike se pandehuri ka kryer kundërvajtje, i cili u shpall përgjegjës dhe ju shqiptoi Masa QORTIM pasi qe u konstatua se ekzistojnë rrethana, të cilat në masë të konsideruar e zvogëlojnë përgjegjësin e kryesës të kundërvajtjes, pasi qe e njëjta e kishte gjendjen e rënd shëndetësore gjatë lindjes dhe pas lindjes, si dhe femiu i posa lindur, dhe për shkak te kësaj gjendje nuk ka qenë në gjendje qe ta mbush këtë formular, dhe po ashtu ka konsideruar se gjatë pushimit te lehonisë nuk është e obliguar qe ta mbush këtë formular, pasi qe ma herët e kishte mbush këtë formular, andaj mund të pritet qe edhe pa dhënien e dënimit, i njëjti ne të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të këtilla dhe të ngjashme, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**

**GJYQTARI PËR KUNDËRVAJTJE**

Fatmir Behrami

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykate dhe pa taksa.